



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2713/9 prot.

Datë 19.11.2025

V E N D I M
Nr.1710/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja "Skenderbeg", Lezhë, godinë private 1 kateshe, në superstradën Lezhë - Shkodër, km 1.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK me NIPT L13329801V dhe adresë: Kavaje Helmes Tiranë Helmes, Shtodher, Ndërtesë 1 katëshe, pranë urës së Draxhit.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “*Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.08.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 21.08.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 01.09.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Agro-Korani	9,376,250 lekë	Kualifikuar
Alb Garden	11,956,000 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 25.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 01.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5876 dhe me nr. protokolli 2713/2025, datë 02.10.2025, e operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr.2713/1 prot., datë 02.10.2025.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 08.10.2025, operatori ekonomik “Agro-Korani” SHPK në cilësinë e subjektit të intersuar në kuptim të nenit 113 të LPP, ka paraqitur formularin e argumentave, formular i cili është protokolluar me tonën me nr.2713/2 prot., datë 08.10.2025.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 7122/8 prot., datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2713/3 prot., datë 15.10.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, vendimin nr.7122/4 prot., datë 09.10.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me

ankesën e operatorit ekonomik, “Alb Garden” SHPK, si dhe dokumentacionin e plotë të operatorit ekonomik “ Agro-Korani” SHPK të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.9. Me shkresën nr.2713/4 prot., datë 23.10.2025, KPP iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit duke kërkuar informacion si më poshtë: “[...]Subjekti “AQScert” SHPK me NIPT L31511026K është akredituar nga ana juaj si organizëm që operon në fushën e Çertifikimit të personelit që mbulon aktivitete trajnimi në fushën e gjelbërimit [...]”.

II.10. Me shkresën nr.2713/5 prot., datë 23.10.2025, me objekt “Vënie në dijeni”, KPP informoi palët e përfshira në proces për ndërprerjen e afatit për shqyrtimin e ankesës nr.2713 prot. datë 02.10.2025, për arsye të kërkesës për informacion bërë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

II.11. Nëpërmjet shërbimit postar, Drejtorisa e Përgjithshme e Akreditimit me shkesën nr.475/1 prot., datë 29.10.2025, me objekt “Informacion mbi statusin e kompanisë “AQSCERT shpk”, protokolluar me tonën me nr.2713/6 prot., datë 30.10.2025, informon si më poshtë: “Në përgjigje të shkresës suaj datë 23.10.2025 me nr Prot 2713/4, ju informojmë që subjekti AQSCERT shpk me NIPT L 31511026K, është akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit si Organizem që operon në fushën e çertifikimit të personit. Data e akordimit të akreditimit është 07.11.2023. Çertifikata është e vlefshme deri më datë: 06.11.2027. Per te aksesuar certifikaten e ketij subjekti mund te vizitoni ëeb tonë në linkun <https://dpa.gov.al/ëp-content/uploads/2025/04/aqscert-cn-017.pdf>.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, me arsyen se: “Operatori Ekonomik “AGRO-KORANI” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar nga AK në pikën 2.3.5 të Shtojcës 8 të DST për punonjësit e kualifikuar sipas ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë, të shoqëruar me kontratë pune... Lidhur me këtë kriter pretendojmë se shoqëria “AGRO-KORANI” sh.p.k., nuk e plotëson kriterin e kërkuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 8 të DST. Më konkretisht sqarojmë Autoritetin Kontraktor se nga informacioni

që ne disponojmë, rezulton se shoqëria “AGRO-KORANI” sh.p.k., nuk ka asnjë punonjës të kualifikuar dhe nuk disponon çertifikata profesionale për punonjësit e saj të lëshuara nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë”. Punonjësit e deklaruar nga OE “AGRO-KORANI” sh.p.k., janë të pajisur me çertifikata nga shoqëria AQScert, por nuk disponojnë asnjë certifikatë profesionale të lëshuara nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës 8, “Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9.**

Ndërsa në shtojcën e publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, “Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit”, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, 2.3.**Aftësitë teknike dhe profesionale**, pika 2.3.5 e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.5 *Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën gjashtë muajt e fundit të cilat i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës:*

- a. 1 (një) Agronom të shoqëruar me diplomë, cv dhe kontrate pune.
 - b. 1 (një) inxhinier Pyjesh i shoqëruar me diplome, cv dhe kontrate pune.
 - c. 1 (një) inxhinier Mjedisi i shoqëruar me diplome, cv dhe kontrate pune.
 - d. 1 (një) Automakinist, i shoqëruar me kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT.
 - e. 1 (një) Eskavatorist i shoqëruar kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartelet personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT.
 - f. 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në sipërfaqe gjelberta” që vërtetohen me çertifikata profesionale, të lëshuara nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë, të shoqëruar me kontrate pune.
 - g. 10 (dhjetë) punëtorë të thjeshtë, të shoqëruar me kontrate pune.
- Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sa më sipër sipas formatit të mëposhtem:

Tab 1

<i>Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Institucionit publik/privat leshues i certifikates/diplomes</i>	<i>Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)</i>
--	-------------------	--	---

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës vetëdeklarimit të DT si dhe me plotësimin e formatit të deklarates sipas Tab 1.

Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Agro-Korani”SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe pranë autoritetit kontraktor, si ofertues në i renditur në vend të parë, referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, pranë KPP me shkresën nr.7122/8 prot., datë 15.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2713/3 prot., datë 15.10.2025, me objekt ”*Dërgohet vendimi i KSHA..*”, dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , ku në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK deklaron:

Deklaratë në lidhje me stafin e angazhuar:

Deklarata		Përzgjedhje	
Një cilësorë e vlerësimit ekonomik, deklaror i nën përzgjedhësit të më poshtë: Unë kam përzgjedhur të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përshkruhet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj		Emri M J Nëse, po, numri i punonjësve: Maj-Oshtori-Korçik	
			

DEKLARATE PER STAFIN E ANGAZHUAR

Me cilesine e administratoritit e shoqerise "AGRO-KORANI" Sh.p.k., deklaroj se per proceduren e prokurimit me objekt "Blerje pembe dekorative", me fond limit 12,500,000 leke pa TVSH te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Dures, per realizimine kesaj kontrate do te angazhohet stafi i mepoeshtem:

Emri Mbiemri i punonjesit dhe nr identifikimi	Profesor..	Institucioni publik/privat lëshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se lëshuesi eshte institucion privat)
.....	Agronom	Universiteti Bujqesor i Tiranes	
.....	Inshinier Pyjesh	Universiteti Bujqesor i Tiranes	
.....	Inshinier mjedisi	Universiteti Politeknik i Tiranes	Mbeshtetje CURRI
.....	Automakinist	DPSHTRR	
Bi.....	Eskavatorist	DPSHTRR	
Dh.....	Punteore fidanshte	AQSCERT Sh.p.k.	L31511026K
.....	Punteore fidanshte	AQSCERT Sh.p.k.	L31511026K
.....	Punteore fidanshte	AQSCERT Sh.p.k.	L31511026K
.....	Punteore fidanshte	AQSCERT Sh.p.k.	L31511026K
.....	Punteore fidanshte	AQSCERT Sh.p.k.	L31511026K

- Certifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me nr.AQS/T/S1292242024, me teme “Kurs Trajnimi per punime në fidanishte”, në emër të Znj. L.K.
- Certifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me nr.AQS/T/S116302023, me teme “Kurs Trajnimi per shërbime gjelbërimi”, në emër të Z. I.H.
- Certifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me nr.AQS/T/S129232024, me teme “Kurs Trajnimi per punime në fidanishte”, në emër të Znj. TeT.H
- Certifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me nr.AQS/T/S116262023, me teme “Kurs Trajnimi per punime në fidanishte”, në emër të Znj. O.K.
- Certifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me nr.AQS/T/S116342023, me teme “Kurs Trajnimi per shërbime gjelbërimi”, në emër të Znj. Dh.K.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë

dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu

referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.9 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, me pretendimin se ky i fundit nuk plotëson kriterin 2.3.5, nga

shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar ndër të tjera: Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën gjashtë muajt e fundit të cilat i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës: 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelberta” që vërtetohen me certifikata profesionale, të lëshuar nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën Shqipërisë, të shoqëruar me kontratë pune. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet se, në lidhje me kërkesën për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelberta” të kërkuara në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Më konkretisht, operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK ka deklaruar si punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelberta” (punonjës fidanishte) Znj.Dh.K, Znj. O.K, Znj. T.H, Z. I.H dhe Znj. L.K. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor, përcjellë pranë KPP me shkresën nr.7122/8 prot., datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2713/3 prot, datë 15.10.2025, nga operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK rezulton, se ky i fundit ka paraqitur certifikata trajnimi lëshuar nga AQSCERT, me temë “Kurs Trajnimi per punime në fidanishte” për të pestë punonjësit e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro Korani”SHPK me pretendimin se punonjësit e deklaruar nga ky i fundit janë të pajisur me certifikata nga shoqëria AQScert, por nuk disponojnë asnjë certifikatë profesionale të lëshuara nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë”, Komisioni vlerësoi të nevojshëm të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) si më poshtë vijon: *Subjekti “AQScert” SHPK me NIPT L31511026K është akredituar nga ana juaj si organizëm që operon në fushën e Certifikimit të personelit që mbulon aktivitete trajnimi në fushën e gjelbërimit.* ,DPA me shkesën nr.475/1 prot., datë 29.10.2025, me objekt “Informacion mbi statusin e kompanisë “AQSCERT shpk”, protokolluar me tonën me nr.2713/6 prot., datë 30.10.2025, informon si më poshtë: “Në përgjigje të shkresës suaj datë 23.10.2025 me nr Prot 2713/4, ju informojmë që subjekti AQSCERT shpk me NIPT L 31511026K, është akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit si Organizem që operon në fushën e certifikimit të personit. Data e akordimit të akreditimit është 07.11.2023. Certifikata është e vlefshme deri më datë: 06.11.2027. Per te aksesuar certifikaten e ketij subjekti mund te vizitoni ëeb tonë në linkun <https://dpa.gov.al/ëp->

<content/uploads/2025/04/aqscert-cn-017.pdf>. Nga verifikimet e kryera në linkun e mësipërm, Komisioni konstaton se, subjekti AQSCERT nuk është i akredituar në fushën e certifikimit të personelit që mbulon aktivitete trajnimi në fushën e gjelbërimit. Po ashtu, nga verifikimet në faqen zyrtare të qkb.gov.al, për subjektin privat AQSCERT, konstatohet se, punonjësit e deklaruar si të certifikuar nga subjekti “AQS CERT”, nuk janë të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi subjekti “AQS CERT” nuk ofron kurse të formimit profesional në fushën e gjelbërimit (Punëtor Kopshtarie). Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK nuk e përmbush kërkesën për kualifikim për 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”punime në sipërfaqe gjelberta” që vërtetohen me certifikata profesionale, të lëshuar nga institucionet e autorizuar sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën Shqipërisë

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, me arsyen se: “OE “AGRO – KORANI” sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kualifikimit 2.3.6 të kërkuar nga AK në Shtojcën 8, pika 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional,... Mjeti me targë AA068MY referuar skedës teknike të mjetit nuk rezulton të jetë Kamionçinë me Vinç, ashtu siç është deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës 8, “Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9.**

Ndërsa në shtojcën e publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, “Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit”, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, 2.3.**Aftësitë teknike dhe profesionale**, pika 2.3.6 e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.6 Operatori Ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Pronesia
--------	-------	----------

<i>Minieskavator</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton) .</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Makineri per shkulje pemesh ekzistuese me thika 40-100/cm (profesionale)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Makineri per Hidrombjelljen e barit me kapacitetmbi 5000 litra</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Makineri me tryele per hapje gropash Ø 60,75,90/cm (profesionale)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>
<i>Pirun (per levizjen e drureve dekorativ)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronesi ose qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikata e transportit të mallrave/Licencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Agro-Korani”SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe pranë autoritetit kontraktor, si ofertues në i renditur në vend të parë, referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, pranë KPP me shkresën nr.7122/8 prot., datë 15.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2713/3 prot., datë 15.10.2025, me objekt ”Dërgohet vendimi i KSHA...”, dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , ku në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK deklaroi:

Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1. Minieskavator	Komatsu			Deklarate Zhdoganimi Dogana Vlore R date 0... Ref
2. Minieskavator	Komatsu			Deklarate Zhdoganimi Dogana Durres date Ref



3. Kamion me vinq		3		Kapaciteti mbajtes 14.3 ton
4. Kamionçine				Masa Max 3.5 ton
5. Kamionçine				Masa Max 3.5 ton
6. Kamionçine	A			Masa Max 3.5 ton
7. Tryeje per hapje gropash profesionale Ø 60-90 cm				Fature Tatimore Shitje date leshuar nga shitesi
8. Pirun				Fature Tatimore Shitje Nr.44, date

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
Kamionçine me vinq. Masa max 3.5 ton dhe kapaciteti mbajtes 1.2 ton				14 date	Afati 12 muaj
Makineri per shkulje pemesh thika 40-100 cm				Kontrate P... petri	Pa afat
Makineri per hidrombjele me kapacitet 5000 litra				Q... P...	Afati 1 vit



-Kontratë qeraje për automjete të lëvizshme lidhur më datë 31.07.2025, midis “Valmira Topalli” P.F. në cilësinë e qeradhënsit dhe OE “Agro Korani” SHPK në cilësinë e qeramarrësit, me objekt Kamioncinë me vinc, me targa XXXX me numër shasie XXXXX, shoqëruar me dokumentacionin siguracion TPL, certifikate e kontrollit teknik dhe taksat, me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

III.2.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, me pretendimin se ky i fundit nuk plotëson kriterin 2.3.6, për disponimin e mjetit të kërkuar Kamioncinë me Vinç nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisje e nevojshme, ku ndër të tjera është përcaktuar edhe Kamioncinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton, pronësi ose qera. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e cituar në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet se, në lidhje me kërkesën për Kamioncinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton të kërkuara në pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Më konkretisht, operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK ka deklaruar me qera kamioncinë me vinc, masa max 3.5 ton, me targa XXX, me nr. Shasie XXX, me qeradhënës V.T p.f., me afat kontrate 12 muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor, përcjellë pranë KPP me shkresën nr.7122/8 prot,. datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2713/3 prot, datë 15.10.2025, nga operatori ekonomik “Agro Korani” SHPK rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.6 për mjetin e deklaruar me targa XXX në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, kontratën e qerasë, lejen e qarkullimit nr. XXXX, certifikatën e kontrollit teknik, foto të mjetit. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni vlerëson se dokumentacioni është i rregullt dhe në përputhje me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 të kriterëve të kualifikimit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative

për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57162-08-05-2025, me objekt: “Blerje pemë dekorative” me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 21.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Agro Korani” SHPK, sipas konstatimeve të shpehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentur veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden”SHPK
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

